

Kontrolli i ndotjes industriale

JAAK në vazhhtë të aktiviteteve të veta për realizimin e objektivave të përcaktuara, më 25 Mars 2010, në Restorantin Freskija, në Prishtinë, ka organizuar seminarin, me temën Kontrolli i ndotjes industriale.

Qëllimi i këtij seminari ka qenë përcjellja e përvojave të pjesëmarrësve të trajnuar në Japoni, në lidhje me kontrollin e ndotjes industriale.


Në seminar morrën pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësuesit e JICA, Z. Mori, konsultant i JICA dhe përfaqësuesit e industriave private dhe publike

Nga kryetarja e JAAK, Znj. Nezakete Hakaj, u bë prezantimi mbi përvojat e marra në Japoni, mënyrën se si Japonia ka menagjuar, për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit, sistemin menagjues mjedisor që aplikohet nga industritë e Japonisë dhe si i ka bartë ato përvoja në Kosovë.

Z. Naser Balaj, anëtar i JAAK, zyrtar i MMPH, prezantoi përvojat e fituara në Japoni gjatë trajnimit, me fokus në mbrojtjen e cilësisë së ajrit, gjendjen e cilësisë së ajrit në Kosovë dhe legjislacionin vendor.

Z. Naim Alidema, zyrtar i MMPH, për kontrollin e ndotjes industriale, prezantoi kornizën ligjore dhe mekanizmat për kontrollin e ndotjes industriale.


Për tu njoftuar edhe me mënyrën e kontrollit të ndotjes, në vet industritë, Prof. Dr. Agron Veliu, menagjer i mjedisit në kompaninë Feronickel dha një prezantim mbi sistemin menagjues mjedisor, në këtë kompani.



Climate change is one of the most urgent crises facing the world. JICA spearheads Japan's activities ëith a series of projects across the world, from the use of satellite technology to the creation of ëind farms in Af-



Së bashku me JICA





Së bashku me JICA

Bashkpunimi JICA me Institucionet e Republikës së Kosovës



Pjesmarrja në takimin regional të asociacioneve Alumni, të Regjionit të Ballkanit, mbajtur me 29 dhe 30 tetor 2009, në Tiranë.



Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i përvojave të asociacioneve të shteteve anëtare të JICA Alumni në Ballkan dhe formimi i grupeve punuese për fusha të ndryshme, me rëndësi për zhvillim të shteteve antare dhe diskutim i planeve për aktivitete në të ardhmen.

Në këtë takim JAAK, si Asociacioni më i ri, u përfaqësua nga Sekretari i sajë, Z. Halit Xhema dhe anëtari bordit Z. Hasan Avdiu.

Për të ngritur bashkpunimin rajonal, në mbyllje të takimit u vendosën objektiva të përbashkëta, për planet dhe aktivitetet që do të ndiqen, krahas aktiviteteve të veqanta të tyre.

Seminari- Hetimi i vendit të ngjarjes pas shpërthimit të eksploziveve dhe bombave dhe analizimi i tyre

Për të përcjellë përvojat e marra nga trajnimet e përcjellura në Japoni, nga pjesëtar të ndryshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës, JAAK , më 11 Shkurt 2009, në Prishtinë, ka organizuar Seminarin e parë me temën **Hetimi i vendit të ngjarjes pas shpërthimit të eksploziveve dhe bombave dhe analizimi i tyre**. Prezantimet u bënë nga Sokol Dedaj, zyrtar nga Policia e Kosovë.



Objektiv e këtij seminari ka qenë njohja me llojet e eklozivëve dhe me teknikat dhe specifikat e rasteve të eksplozimit. Në seminar morrën pjesë 33 pjesëmarrës, nga institucionet relevante të Kosovës; nga radhët e policisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së punëve të brendshme, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfaqësuesve të JICA, të cilët me një fjalë rasti përshëndetën të pranishmit.

Prezantimet e bëra zgjuan interesim të lartë nga pjesëmarrësit, të cilët u ndërlihdhen me pyetje të shumta dhe diskutime. Në fund të Seminarit u nxorrën konkluzionet, që rrjedhën nga vet pjesëmarrësit.

9 Shkurt

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Avni Kastrati dhe drejtori për Infrastrukturë dhe Shërbi-me Publike, Rasim Veseli, kanë pritur të martën në takim një delegacion të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, të kryesuar nga këshilltarja e kësaj organizate, Jumi Jasuda, më të cilët kanë biseduar për projektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit.

Në këtë kontekst, përfaqësuesit e kësaj organizate kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar në këtë fushë dhe janë interesuar për gjendjen në fushën e ambientit, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e përgjithshme për këtë aspekt.